

REXHEP ISMAJLI

**FJALA E PËRFUNDIMEVE TË KONFERENCËS “MARTIN
CAMAJ NË KULTURËN SHQIPTARE”**

Të nderuar pjesëmarrës të Konferencës shkencore “*Martin Camaj në kulturën shqiptare*”,

Konferencës sonë po i afrohet fundi. Në një ditë të gjatë diskutimesh në këtë tempull të dijes dëgjuam 36 kumtesa për aspekte të ndryshme të veprës së shkrimtarit dhe albanistit të shquar shqiptar të gjysmës II të sh. XX, Martin Camajt. U mbajtën dy fjalë të hyrjes, u sollën shënime të reja për jetën e tij dhe u dëgjua një fjalë e gjallë e Martinit.

Në kulturën tonë të zhvilluar me kapërcime, golla, ndalesa, po kemi ende nevojë për të rehabilituar apo për të kthyer në jetë normale vepra e autorë të lënë anash, apo edhe më keq, të pamundësuar.

Martin Camaj është studiues dhe shkrimtar që në kulturën shqiptare ishte dhe s’ ishte. Si shkrimtar ai nisi në Prishtinë, ku dy librat e tij të parë patën mundësi të lexoheshin. Me kalimin e tij në Romë librat e tij në vijim në Tiranë vazhduan të shpërnjiheshin, në Prishtinë të lexoheshin me gjysmë të vjedhur, ndërsa mundësitë e diasporës ishin ato që ishin.

Fazën e botimeve të Camajt në Mynih e karakterizon ajo që njihet si modernitet i Martin Camajt në poezi – vitet 1967-1992. Ajo po ndodhte në kohën kur poezia moderne në Kosovë tashmë kishte shënuar arritjet e autorëve si Azem Shkreli, Ali Podrimja, Rrahman Dedaj dhe po kalonte te brezi i Eqrem Bashës, Sabri Hamitit, e madje te brezi në vijim. E vërteta është se ajo po lexohej në Kosovë në kohën e vet falë qarkullimit të të rinjve në Perëndim, por është po ashtu e vërtetë se Martinit nuk po i kthehej jehona e leximeve të veprës së tij. U desh të priteshin vitet ’90 që letërsia e tij të vinte pak më çlirshëm në Kosovë dhe për herë të parë në Shqipëri. Më 1995 në Tiranë pati një botim të veprës së Camajt në 5 vëllime nga Ardian Klosi, me ç’rast nuk u përfshinë 2 vëllimet e botuar në Prishtinë të viteve 1953-54. Në Prishtinë në ato vite pati botime veprash të veçanta, ndërsa në vitin 2000 Dukagjini i Pejës botoi të gjitha poezitë e M. Camajt në vëllimin “*Lirika*”, ku përfshiheshin dhe variantet dhe dorëshkrimet. Ndërkohë, përveç shkrimeve të shpërndara në formë artikujsh, studimesh, parathëniesh, për veprën letrare të Camajt u botuan

dhe monografi, çka tregon se leximi i veprës është në rrjedhë dhe interesimi që ka zgjuar ajo nuk është i vogël.

Vepra e Camajt qysh me të gjallë të tij, sidomos lirika, ka përjetuar përkthime gjermanisht, italisht e anglisht në plotni më të madhe, ndërsa në antologjitë dhe përzgjedhjet e bëra ndërkohë në gjuhë të ndryshme poezia e tij është vazhdimisht e pranishme. Për këto aspekte në këtë konferencë nuk pati diskutime.

Diskutimet e sotme janë një ndihmesë me vlerë për sqarimin e shumë çështjeve dhe për kthimin e veprës së Camajt në jetë normale, për poetikën e Camajt dhe për aspekte të ndryshme të saj. Po shihet qysh tash se vepra letrare e Martin Camajt tashmë po merr një dimensionim të ri.

Në studimet albanistike Camaj spikat studiues i veprës dhe gjuhës së Gjon Buzukut dhe teksteve të vjetra shqipe. Si më parë, edhe në këtë konferencë me të drejtë u cilësua si një nga buzukologët më të mëdhenj.

Martin Camaj njihet si një nga studiuesit e shquar të historisë së fjalëformimit shqip, sidomos në suaza të sistemit emëror, për çka nuk u fol sot. *Albanische Wortbildung* e botuar më 1966 që cilësuar e rëndësishme në atë kohë nga recensues të ndryshëm, ndër të cilët dhe I. Ajeti dhe vazhdon të referohet edhe sot në studimet e specializuara. Mbase del e nevojshme të përkthehet nga gjermanishtja.

Martin Camaj është shquar dhe për studimet e të folmeve arbëreshe, për çka pati disa diskutime, por mund të flitet edhe më shumë. *Albanian Grammar* e tij zë vend të veçantë në gramatologjinë e kohës krahas gramatikave të Akademisë, të Buccholz-Fiedler-it, të Newmark-ut e të Resselit, me synimin që të paraqiste në një vend strukturat e shqipes standarde të gegërishtes e të arbërishtes. Për çështje të ndryshme të kësaj fushe pati mjaft diskutime. Të shpresojmë se leximi i vëmendshëm i saj do të ketë dhënë impulse për vështirime të mëtejme të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë gramatologjike të tij.

U diskutuan gjithashtu aspektet standardologjike të veprës së tij, aspektet e begatisë leksikore në veprën e Camajt, etj.

Më duket se Konferencës do t'i rritej vlere edhe më shumë po të kishte pak më tepër hapësirë për diskutime.

Mënyra e vetme që për autorë të shquar të kulturës sonë të mos na ndodhë më të na thuhet se nuk e kuptojnë për arsye nga më të ndryshmet është pikërisht kjo: të vihen në qarkullim normal veprat e tyre dhe të flitet për to pa paragjykime.

Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre: zëvendësministri i Kulturës Z. Shamata, Presidenti i Shoqatës Dukagjini, përfaqësues të

Fjala mbyllëse

Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe zonja Erica Camaj. Të gjithëve u shprehim falënderimet më të ngrohta.

Falënderimet më të ngrohta u shprehim organizuesve të Konferencës, Qendrës së Studimeve Albanologjike me në krye drejtorin e saj Prof. Dr. Ardian Marashi dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij për parashikimin e saktë të të gjitha zhvillimeve, për ecurinë e përsosur të Konferencës dhe për mikpritjen e jashtëzakonshme të të gjithë neve.

Mirupafshim në Konferenca të tjera.